

ABSTRAKT

Qëllimi i këtij punimi është fitimi i pronësisë në sende të luajtshme, duke përfshirë mënyrat e fitimit të pronësisë, përmes titujve derivativ dhe origjiner.

Me anë të pyetjeve hulumtuese kemi qartësuar përmbajtjen e pronësisë, mënyrat e fitimit të saj, rregullimin ligjor të pronësisë në Kosovë dhe aspektet krahasuese, si dhe trajtimi i problemeve që hasim në praktikë, sa i përket fitimit të pronësisë në sende të luajtshme.

Përveç trajtimit të kësaj teme në aspektin teorik dhe të kornizes ligjore nacionale, punimi trajton edhe aspektin krahasues të fitimit të pronësisë në sende të luajtshme në disa vende të Evropës. Gjatë hulumtimit janë vërejtur disa dallime të vogla mes legjislacionit vendor dhe legjislacioneve të huaja, por që thelbi dhe qëllimi janë thuajse të njëjtë.

Gjithashtu dukshëm vërehet ndikimi i legjislacioneve të huaja në atë të Kosovës, sa i përket këtyre qështjeve.

Gjatë realizimit të këtij punimi janë përdorur metodat shkencore si Metoda hulumtuese me qëllim të identifikimit, mbledhjes, shfrytëzimit të literatures juridike, asaj vendore dhe të huaj si dhe materialeve të shkruara dhe elektronike. Metoda e analizimit - me të cilën analizohen legjislacionet, ligjet aktuale dhe praktikat e implementimit të tyre. Metoda krahasuese - e përdorur për të bërë një krahasim sa i përket kornizës ligjore të Kosovës me sistemet tjera juridike por edhe vet legjislacionit nacional në periudha të ndryshme kohore.

Fjalë kyçe: Pronësia, mënyrat e fitimit, sistemet juridike, krahasimi.